KOMUNA FUSHE-BULQIZE

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT

(2008-2013)

MESAZHI I KRYETARIT TE KOMUNES FUSHE-BULQIZE

Hapsira zhvillimi për komunën

Komuna e Fushe Bulqize , me eksperiencën që ka fituar gjatë kësaj dekade, po kalon fazën e tranzicionit dhe po hyn në një zhvillim të qëndrueshëm.

Të ndërgjegjësuar për këtë realitet të ri dhe në harmoni me studimin, zbërthimin dhe adaptimin në kushtet e komunës sonë të Strategjisë Rajonale te Zhvillimit për Qarkun e Dibres, unë mendoj se ishte momenti më i natyrshëm, favorizues dhe i përshtatshëm për të ndërmarrë inisiativën e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal të komunës së Fushe Bulqizes.

Plani i Zhvillimit Lokal do të krijojë një hapësirë të re zhvillimi për komunën tonë. Ne kemi ambicjen që duke kuptuar objektivat strategjike të fushave prioritare të zhvillimit, banorët e komunës sonë në një të ardhme të afërt do të kenë një mirëqënie më të lartë dhe do të jetojnë në një ambjent me shpresëdhënës për të rinjtë dhe të vegjlit e tyre.

Por më duhet të pranoj se organizimi dhe realizimi i një proçesi të tillë, me pjesëmarrje kaq masive e cilësore njëherësh nuk mund të kryhej prej nesh pa mbështetjen e Këshillit të Komunës, administratës së komunës, dhe komunitetit të Fushe Bulqizes. 20 anëtarë të Grupit të Planifikimit të Zhvillimit Lokal dhe 7 anëtarë të Grupit të Vlerësimit dhe Monitorimit me Pjesëmarrje kontribuan shumë ore të kohës së tyre në hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal. Mbi 93 përfaqësues të komunitetit morën pjesë në Panairet e Ideve te zhvilluara në fshatra dhe opinionin e tyre për zhvillimin e komunës dhe të fshatrave të tyre, opinion i cili u integrua në Visionin e Komunës dhe në objektivat strategjike. Gjimnazistët tanë ndihmuan në intervistimin e 45 familjeve që u realizua për të grumbulluar informacion për kënaqshmërinë e komunitetit në lidhje me shërbimet që ofron komuna. Të gjitha këto përpjekje janë pasqyruar në këtë plan bashkëkohor me vizion që do ti shërbejë komunitetit tonë në të ardhmen.

Dhe së fundi, deklaroj me kënaqësi e siguri të plotë se kemi hartuar një plan mobilizues, cilësor e ambicioz dhe se kemi kryer një shkollë për të qeverisur më mirë dhe të gjithë së bashku.
Faleminderit

Isuf CURRI
Kryetari i Komunës Fushe Bulqize

PROFILI I KOMUNES

INFORMACION HISTORIKO-GJEOGRAFIK

POZITA GJEOGRAFIKE E KOMUNËS

Komuna e Fushe Bulqizes është njësi administrative e qarkut të Dibres Ajo shtrihet në lindje të qytetit të

Bulqizes, në një distancë prej 10 km (qytet – qendër e komunës). Ka një sipërfaqe të përgjithshme 28 km² dhe është e ndarë në 4 fshatra: Fushe Bulqize, Dushaj, Kocaj, Dragu. Dendësia e popullsisë është 12 banorë për m². Komuna ka 708 ha tokë të shpërndarë në 4 fshatra: Fushe Bulqize 310 ha, Dushaj 163 ha, Kocaj 137 ha, Dragu 98 ha.



HISTORI E SHKURTER

Komuna e Fushe Bulqizes është njësi administrative e qarkut të Dibres. Ajo shtrihet në lindje të qytetit të Bulqizes, në një distancë prej 10 km (qytet – qendër e komunës). Njihet si vendbanim që në Mesjetë. Treva e Fushe Bulqizes është e banuar qysh në periudhen e Principates se Arbrit. Për herë të parë Fushe Bulqiza gjendet i regjistruar si fshat në vitin 1838. Per shkak te pozicionit gjeografik , treve jone eshte e njohur per lufterat e zhilluara qe ne kohen e Skenderbeut, dhe betejat e panumerta, per shkak te rruges qe lidh Shqiperine me Dibren e Madhe. Ushtrite armike kane levizur vazhdimisht ne kete rruge, prandaj vendbanimet e para datojne vone dhe kane qene vendosur kryesisht ne skaje te Komunes si Kokerdhak, Dushaj etj. Ne kohen e principates Arbrit, ne skajin lindor (Sot Ura e Qytetit) ka qene vendosur nje garnizon ushtarak qe ruante karvanet nga grabitjet. Garnizoni vendosej ne nje pike strategjike me emertimin Kalaja e Voles. Fiset e para u vendosen ne Dushaj, Kokerdhak e Dragu, fshatra te sotem me emrtime te ndryshme ne ate kohe qe u pershtateshin toponimeve Ilire. Ne treven tone egzistojne shume vende me emertime ilire dhe sidomos ato te periudhes se Skenderbeut. Ato sot vizitohen nga shume te huaj dhe vendas. Treva jone ka nje shtrirje prej rreth 28 km 2 ne luginen e Bulqizes.

POPULLSIA

Komuniteti dhe Dinamika e tyre

Lëvizja e popullsisë në Qarkun e Diber gjatë 10 viteve të fundit është ndier edhe në komunën e Fushe Bulqizes. Numri i familjeve (viti 2007) në komunë është 1024 dhe duke u krahasuar me numrin e familjeve në vitin 2002 shihet se ka një emigrim të 229 familjeve gjatë shtate viteve të fundit. Kjo reflekton dhe tendencën e lëvizjes së familjeve brënda vendit nga zona malore në ato fushore apo emigrimit jashtë vendit. Sidoqofte shkalla e papunësisë në komunë është e konsiderueshme. Këto të dhëna mbështesin edhe prioritetet e komunës për përmirësimin ekonomik dhe shtimin e mundësive për punësim.

Popullsia e Komunes Fushe Bulqize

Nr Fshati/Lagjia	Numri i banorëve			Numri i familjeve në vitet	
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	2002	2007
Dushaj	570	536	1106	390	306
Fushe Bulqize	726	768	1444	418	399
Dragu	333	290	623	290	122
Kocaj	382	327	709	215	197
Njesia (Total)	2011	1871	3882	1253	1024

PUNESIMI

Asistenca Sociale

Ka dy kategori njerzish që përfitojnë asistencë sociale: familjet pa të ardhura dhe familjet me të ardhura më të vogla se niveli i jetesës.

Komuna e Fushe Bulqize numëron 250 familje (25 %) që përfitojnë asistencë sociale. Sikurse shihet dhe në figurën 7 këto familje janë të shpërndara në 4 fshatra. Pjesa më e madhe e atyre që përfitojnë asistencë sociale ndodhen në Fushe Bulqize ku numri arrin deri në 97 familje (duke përfaqësuar kështu 30% të numrit total të familjeve në këtë fshat)

Cilësia e Jetës

Me gjithë këto sfida në fushën e arsimit dhe shendetit, ne përgjithësi banorët e komunës së Fushe Bulqizes janë të kënaqur me cilësinë e jetës, 60% e tyre shprehen që janë të kënaqur me cilësine e jetës dhe 68% besojnë se gjendja e komunës do te ndryshoje me shume ne keto vite.

Burimet e konsiderueshme njerëzore e natyrore të komunës mundësojnë plotësisht një zhvillim tëqëndrueshëm të komunës së Fushe Bulqizes. Komuna numëron 2,132 banorë (72.5 % e

BURIMET NJERËZORE

Nr	Emertimi	Gjithsej	Punesuar	Te papune
	Me arsim te larte			
1	Ekonomist	1	1	
2	Agronome	3	2	1
3	Inxhinjere	9	7	2
4	Mesues	10	8	2
5	Mjek	1	1	
6	Te tjere	4	3	1
	Totali	**28**	**22**	**6**
	Me arsim te mesem			
1	Ekonomik	3	2	1
2	Agranom	2		2
	Te pergjithshem	388	138	150
	Totali	**393**	**140**	**153**

popullsisë) që janë aktivë si forcë pune. Gjithashtu është një numër i konsiderueshëm personash me arsim të lartë (universitet) dhe arsim të mesëm që kanë profesione të ndryshme sikurse tregohet në figurën e meposhtme. Një pjesë e mirë e banorëve të arsimuar janë punësuar në sektorin publik.

Afërsisht 162 banorë, nga të cilat 42 gra janë punësuar në degë të tjera si transporti, shërbimet tregtare, bare dhe restorante, shëndetsia dhe shërbime të tjera duke përfshirë bujqësinë dhe blegtorinë.

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë lokale të Fushe Bulqizes i jep prioritet disa fushave të zhvillimit ekonomik, është e justifikueshme që të kemi më shumë detaje.

ARSIMI

Në komunën e Fushe Bulqizes objektet arsimore janë të përqëndruara në kater fshatrat: Fushe Bulqize, Dushaj, Kocaj, Dragu dhe Qender. Aktualisht Fushe Bulqiza numëron nje shkolle 9-vjeçare në të cilën mësojnë 561 nxënës dhe ka 33 mësues. Në komunë ka dhe 5 kopshte fëmijësh në Fushe Bulqize ne te gjitha fshatrat me një total prej 99 fëmijësh, Qarku i Dibres ka mungesë mësuesish të kualifikuar veçanërisht në fshatra dhe zona të izoluara, gjë që ndikon direkt në cilësinë e të mësuarit dhe arsimimit në këto zona. Sidoqoftë, raporti i mësuesve në shkollat 9 vjeçare është një mësues për 20 nxënës.

Shpërndarja e shkollave, nxënësve dhe mësuesve në komunën e Fushe Bulqize

	Arsimi	Nr. nxenesve	Nr. mesuesve	Nr. klasave	Raporti Nx/Mesues	Raporti Nxenes/ Klase	Nr. Nxenesve femra	Nr. mesuesve femra
1	Parashkollor	99	5	5	20/1	20/1	42	5
2	CU	268	17	17	16/1	16/1	128	14
3	9-vjecar	293	16	11	19/1	26/1	139	6
4	Mesem	--						
5	Profesional	--						
	KOMUNA	660	38	33	18/1	25/1	302	25

SHËRBIMI SHËNDETSOR

Shërbimi shëndetsor në komunën e Fushe Bulqizes realizohet nëpërmjet strukturave të shërbimit shëndetsor parësor. Sistemi shëndetsor në komunë përbëhet nga një qendër shëndetsore dhe 3 ambulanca ku punojnë 1 mjek dhe disa infermierë dhe mami. Ashtu si në gjithë qarkun e Dibres dhe në vendet më të ardhura të vogla, edhe në komunën e Fushe Bulqizes sëmundjet infektive dhe përhapja e tyre janë një problem për komunitetin. Kjo situatë e bën të domosdoshme riorganizimin e strukturave shëndetsore parësore në fshatra që kanë mungesë të këtij shërbimi në mënyrë që të plotësoj standartet rajonale për zonat rurale. Megjithëse fshatrat kryesore kanë shërbim ambulator me infermierë dhe një doktor që shkon një herë në javë në fshatra për vizitë, prapë ka nevojë për përmirësimin e kujdesit shëndetsor, duke përfshirë një personel të kualifikuar. Gjithashtu këto ambulanca kanë dhe mungesë të pajisjeve të domosdoshme mjekësore dhe ilaçeve.

Në përgjithësi komuna nuk vuan nga kushtet higjenike dhe kanalizimet. Pothuajse 70 % e komunitetit shpreh kënaqësi për nivelin e higjenës në komunë në përgjithësi dhe kjo shifër rritet në 80% kur komuniteti pyetet në veçanti për fshatrat..

Plani i Zhvillimit Lokal për Fushe Bulqizen, ka përcaktuar disa objektiva dhe hapa veprimi konkrete për përmirësimin e situatës shëndetsore të komunitetit për të arritur standartet europiane.

B. EKONOMIA LOKALE

Zhvillimi aktual ekonomik i komunës përfshin disa drejtime e aspekte kryesore Nxitja dhe përkrahja e këtyre bizneseve është përmendur edhe në Planin e Zhvillimit Lokal.

Pavarësisht nga gjithë këto mundësi për zhvillim, në qoftë se bëjmë fjalë për burimet natyrore dhe kapitalin Social, niveli i ulët i papunësisë i tejkalon avantazhet e këtyre aseteve. Opinioni i komunitetit e reflekton më së miri këtë problem. Kur janë pyetur për mundesitë e punësimit në komunë, 56.6 % e banorëve janë shprehur të pakënaqur.

BUXHETI I KOMUNËS

Buxheti i komunës për vitin 2007 është 14.468,000 lekë,. Kjo sasi sikurse vihet re dhe në figurën 26 është shtuar shumë pak në tre vitet e fundit. Pjesa më e madhe e të ardhurave vjen nga fondi i kushtëzuar i qeverisë dhe buxheti i shtetit.

Kontributi i komunës në krijimin e të ardhurave mbetet i vogël dhe është 300,000 lekë, pra rreth 4 % e shumës totale të buxhetit. prej të cilit pjesën dërrmuese e kapin shpenzimet operative. Pjesa më e madhe e buxhetit shkon për shpenzimet operative dhe vetëm 4.000.000 lekë (26.6%) janë planifikuar për investime kryesisht për rriuget, ujësjellësat.

Në vitet në vazhdim komuna synon të rris të ardhurat kryesisht nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël dhe nga disa tarifa shërbimi (zgjerim baze jo rritje niveli).

Shpenzimet e Komunës për vitin 2007

Nr	Emertimi	Aparat	Arsim
1	Energji elektrike	50	50
2	Shpenzime telefonike	50	---
3	L. djeg. (dru zjarri)	50	250
4	Dieta e sherbime	300	30
5	Karburant (nafte)	400	----
6	Pjese kemb. e lubrif.(aparat e shendetsi)	300	----
7	Blerje kancelari e paisje zyre	350	50
8	Riparim,lyerje e sherbetim ndertesash	50	100
9	Aktivitete kulturore	---	100
10	Blerje paisje, materiale te ? e sherbime.	140	80
11	Shpenzime postare	40	----
12	Mirembatje ambjentesh shkollore	----	200
	TOTAL	**1730**	**860**

Ndarja e shpenzime te tjera koherente

Nr	Emertimi	Shuma (000/lek)
1	Sherbim me roje private repetitori televiziv TVSH	250
2	Sherbim me roje private Zyrat e Komunes (dy turne)	500
3	Studime projektimi +sherbime juridike	230
4	Sherbim me roje private Ujesjellesi Kaculit	250
5	Sherbim pastrimi sanitare (arsim, parat)	390
6	Sherbime Keshilli Komunal (seanca keshillimi me bashkesine) aktivitete sociale	120
7	Sherbime e mirembatje ujesjellesash komunal ne te gjithe fshatrat	300
	T O T A L	**2040**

TURIZMI

Komuna e Fushe Bulqizes ka burime natyrore të pasura e të shumllojshme. Ka disa zona te mrekullueshme, zona banimi, qe paraqesin interes të madh kulturor dhe historik. Banorët e Fushe Bulqizes janë të ndërgjegjshëm për këto burime dhe po përpiqen ti shfrytëzojnë disa për të gjeneruar të ardhura. Në komunë ndodhet dhe një restorant, si dhe disa kafe të vogla. Ka filluar të zhvillohet turizmi familjar, sidomos muajt e verës, duke e konsideruar frekuentuesit, si një vend klimatik të shkëlqyeshëm.

BURIMET NATYRORE

Komuna e Fushe Bulqizes ka burime të pasura dhe të shumëllojshme natyrore. Ajo ofron një pejsazh të bukur kryesisht malor, me pyje të shumta e kullota masive, me ujra sipërfaqësore e nëntokësore të bollshme e cilësore, mes tyre edhe laguna, me masive shkëmbore që i japin variacion në formë e në ngjyrë këtij pejsazhi.

Fushe Bulqizes ka sipërfaqe të konsiderueshme me pyje të llojeve të ndryshme e cila ka një bukuri natyrore mbreslënëse. Këto pyje sigurojnë lëndë drusore për djegie, ndërtim etj. ndërkohë ndikojnë në rritjen e shkallës së erozionit dhe probleme të tjera të ambjentit. Në këto pyje rriten shumë bimë medicinale të cilat njerzëit po i shohin si burim fitimi. Pyjet e larta janë në gjendje relativisht më të mirë ndërsa korijet dhe pyjet shkurrore janë dëmtuar seriozisht nga prerjet e pakontrolluara.

BUJQËSIA

Bujqësia dhe blegtoria përbëjnë sektorin kryesorë të punësimit në komunën e Fushe Bulqizes.

Bujqësia në komunën e Fushe Bulqizes ashtu si në të gjithë vendin ka pësuar ndryshime te mëdha gjatë periudhës së tranzicionit. Qarku karakterizohet nga ferma të vogla për sa i takon sipërfaqes së tokës (1.24 ha për rrethin e Dibres) dhe fragmentizim te brëndshëm të fermave në 4-8 pjesë. Kjo pengon në mënyrë të konsiderueshme produktivitetin e tyre. Gjatë reformimit, krahas me tokën u shpërndanë dhe asete të tjera si traktore, stalla etj. Toka bujqësore, me një siperfaqe prej 708 ha, është vendosur mbi një terren malor me pjerrësi mbi 25%. Struktura e tokës në komunën e Fushe Bulqizes tregohet në figurë. Ndryshimet në politikat e bujqesisë influencuan edhe prodhimin dhe orientimin e prodhimeve në komunë sikurse në gjithë qarkun e Dibres.

Struktura e Tokes ne Komunen e Fushe Bulqizes

Nr	Fshati	Toke Bujqesore (ha)				Pyje (ha)	Livadhe kullota (ha)	Të tjera
		Ara (ha)	Pemishte (ha)	Ullishte (ha)	Vreshta (ha)			
1	Fushe Bulqize	276	22	0	12			
2	Dushaj	140	18	0	5			
3	Kocaj	122	12	0	3			
4	Dragu	85	10	0	3			
TOTAL		**623**	**62**	0	23			

BLEGTORIA

Ky sektor, është sektori ekonomik kryesor për komunën dhe numëron 500 të punësuar. Blegtoria është sektor tërheqës dhe vazhdimisht në rritje për komunën. Kushtet natyrore të komunës favorizojnë rritjen e deleve, dhive dhe gjedheve. Numri i krerëve në përgjithësi ka ardhur duke u rritur nëse i referohemi tabelës që bën një krahasim të vitit 2007me atë të 2005. Ky zhvillim mund të shpjegohet me disa faktore si: kërkesa në rritje për produkte blegtorale, shtimi i sipërfaqeve me foragjerë (ekzistenca e tokave për kullotë, që zënë 5500 ha në komunë), shpenzime jo te mëdha për zhvillimin e gjësë së gjallë, si dhe përshtatja e fermës së vogël për të rritur gjënë e gjallë.

Megjithëse prodhohet mish, pikat e përpunimit të mishit në komunë mungojnë dhe kushtet në përgjithsi janë shumë të këqija. Ka vetëm dy pika te vogla për grumbullimin e qumështit, por këto pika nuk i plotësojnë nevojat e fermerëve në komunë, të cilët kanë përmendur si proritet ndërtimin e një baxhoje të re dhe moderne në komunë. Një nga problemet kryesore të zhvillimit të blegtorisë mund të përmendim përmirësimin racor, përmirësimin e strukturës së të ushqyerit, krijimi i kushteve të përshtatshme higjeno-sanitare, dhe rritja e numrit të krerëve në çdo fermë.

C. INFRASTRUKTURA DHE SHERBIMET

SISTEMI RRUGOR

Nga pikpamja administrative rrjeti rrugor ka dy pronarë: drejtoria e rrjetit rrugor rural dhe komuna. Rrjeti rrugor dhe transporti është një nga instrumentat për zhvillim dhe duke qenë i tillë në vitet e fundit janë bërë investime të rëndësishme në rrjetin rrugor rural duke përdorur fondet e buxhetit të komunës.

Qëndra e komunës lidhet me qytetin e Bulqizes nëpërmjet rrugës nacionale Bulqize -Peshkopi dhe segmentit rrugor Ura e Re - Qender Komune. Me përjashtim të 2 km të paasfaltuar ende, pjesa tjetër e këtij segmenti

është e asfaltuar. Me problematike mbetet rrjeti rrugor që lidh fshatrat e komunës. Rreth 22,5 km rrugë auto lidhin fshatrat e komunës me qendrën e komunës dhe me rrugën nacionale. Ato janë të paasfaltuara. Rrugët brenda fshatrave janë të kalldrëmta por me cilësi që lenë për të dëshiruar.

Sipas anketimit të realizuar, banorët e komunës Fushe Bulqize nuk janë të kënaqur me situatën aktuale të rrugëve në komunën e tyre.

UJI I PIJSHEM

Furnizimi me ujë të pijshëm të komunitetit, aktualisht përbën një prioritet për qeverisjen qendrore dhe atë vendore. Kjo shikohet jo vetëm në aspektin sasior por edhe atë cilësor dhe të dy lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë. Për furnizimin me ujë të pijshëm në komunë përdoren kryesisht dy mënyra: me ujesjëllës dhe puse. Furnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë së komunës realizohet prej 8 ujësjellsash, 25 km linjë e jashtme dhe 9 km rrjet i brendshëm i fshatrave. Nga 1024 familje që ka aktualisht komuna, 750 (72%) prej tyre furnizohen me ujë të pijshëm nga rrjeti. Pjesa tjetër përdor kryesisht puset apo burimet.

KANALIZIMI I UJRAVE TË ZEZA DHE TË BARDHA

Kanalizimi i ujrave të zeza dhe të bardha është një element i infrastrukturës që ka filluar të vlerësohet sidomos në vitet e fundit. Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujrave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin.

Kanalizimi i ujrave të zeza është i pjesshëm. Aktualisht kjo përbën dhe një problem për komunën.

TELEKOMUNIKACIONI DHE TEKNOLOGJIA INFORMUESE

Në komunën e Fushe Bulqizes është shumë i përhapur komunikimi me rrjetin e lëvizshëm telefonik prej kompanive AMC e Vodafone. Megjithatë banorët kanë nevojë për përdorimin e telefonisë fikse. Në panairet e ideve të organizuara në fshatra banorët e Fushe Bulqizes përmendën një vizion të komunës me shërbim postar dhe telefonik të zhvilluar.

Përsa i përket shërbimit postar në komunë ekziston vetëm një postë. Nuk mund të flasim për Teknologji informuese pasi në Fushe Bulqize nuk ka asnjë linjë interneti apo kompjutera.

D. QEVERISJA VENDORE

Pushteti lokal bazohet në dy shtyllat kryesore: administrata e komunës dhe këshilli i komunes. Këshilli është organ vendimarrës dhe përbëhet nga përfaqësuesit e partive politike që zgjidhen direkt nga populli. Anëtarët e këshillit zgjedhin Sekretarin e Këshillit të Komunës dhe komisionet, ndërsa kryetari i komunes, i cili zgjidhet direkt nga populli, përzgjedh punonjësit e administratës.

Organika e Komunës Fushe Bulqize



E. ANALIZA E SITUATES

A. KARAKTERISTIKAT E ZONES

- Fushe-Bulqiza shquhet per njerez punetor, te urte dhe arsimdashes .
- Pasuri te shumta natyrore, Pyje, Lumenj e perenj,
- pasuri te shumta minerale.
- Prodhime te shumta druresh frutore natyral si geshtenja, arra, kajsia, thana dhe bime medicionale.
- Ka tradite kulturore te pasur dhe shquhet per etnografine dhe kostumografine.

B.TENDENCAT

- Ndertime te medha shtepish ne zonen fushore pergjate rruges nacionale nga banoret e vete komunes.
- Investime jo vetem ne shtepi por dhe vreshtari e pemtari
- Krijimi rezarvatit te peshkut
- Investime ne bare dhe ne lokale, ne qendra te medha tregtie dhe ne sherbime si Foograf, stamatolog, farmaci, riparime, karburante etj.
- Emigrimi
- Shfrytezimi i vendeve te bukura turistike per sherbime per vizitoret vendas dhe ata nga bulqiza e Peshkopia
- Mbeshtetje nga Ministria e Bujqesise per pemtarine, per fermeret qe mbjellin vresht dhe fruta.

C.MUNDESITE

- Ruga e Arberit qe ka filluar te ndertohet.
- Pasurite natyrore minerale dhe hidrike per centrale te vegjel
- Afersia me qytetin e Bulqizes
- Pikat Turistike dhe shfrytezimi i tyre
- Programi i Amasades Hollandeze me Qarkun Diber

D.RRISQET

- *Mungesa e investimeve nga donatoret e huaj dhe ata vendas.*
- *Largimi i njerezve per ne zonat metropolitane dhe ne zonat urbane.*
- *Pasiguria e kushteve te punes ne minieren e Bulqizes ka bere qe te bien te ardhurat per familjet qe punojne ne te.*
- *Sasia e vogel e prodhimeve dhe mundesive per te dale ne Treg*
- *Zvogelimi i te ardhurave qe vijne nga emigracioni per arsye se kane filluar te investojne dhe jetojne ne vendet ku kane shkuar.*
- *Nuk ka nje siguri politike qe subvencioni nga Ministria e Bujqesise per Fermeret do te vazhdoje dhe nga ky subvencion nuk fitojne fermeret e vegjel qe kane pak toke.*

VIZIONI DHE STRATEGJITE SEKTORIALE

VIZIONI:

Fushe Bulqiza është një komunë që nën qeverisjen e mirë vendore ka një bujqësi dhe blegtori të zhvilluar, një infrastrukturë bashkëkohore dhe rrjet shërbimesh cilësore duke krijuar një mjedis komod jetese për komunitetin në sajë të përdorimit efektiv të burimeve të veta njerëzore dhe natyrën e saj të bukur.

OBJEKTIVAT:

1. sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal permes zhvillimit te bujqesise, blektorise, turizmit loka,l menaxhimit te mire te burimeve natyrore dhe bisnesit.
2. permiresimi dhe ngritja e nje infastrukture te re dhe funksionale ne te gjithe territorin e komunes
3. sigurimi i nje zhvillimi te kenaqshem social, me kushte te mira per arsimin, shendetesine, kulturen, sportin etj.
4. fuqizimi I qeverisjes se mire lokale.

1. ZHVILLIMI EKONOMIK:

Zhvillimi ekonomik shihet ne 3 aspekte kryesore:

- zhvillimi i bujqesise dhe blegtorise
- menaxhimi i mire i burimeve natyrore

Fusha Prioritare 1: Zhvillimi Ekonomik

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Zhvillimi i Blegtorisë
2. Zhvillimi i Bujqësisë natyrore/ biologjike.
3. Zhvillimi i Ekoturizmit
4. Nxitja e biznesit të vogël dhe të mesëm

1.1. ZHVILLIMI I BLEGTORISË

TENDENCA:

Ekonomia e komunës sonë është mbështetur në zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë dhe ka ofruar më shumë mundësi dhe kushte më të përshtatshme fermerëve vendas në shtimin e bagëtive dhe prodhimtarisë dhe në të njëjtën kohë ngritjen e një infrastrukturë të përshtatshme për nxitjen e bizneseve ëe për përpunimin dhe tregtimin e këtyre prodhimeve.

Zhvillimi ekonomik i komunës ka sjellë rritjen e te ardhurave dhe përimirësimin e jetesës së banorëve të saj.

SYNIMI STRATEGJIK:

Zhvillimi i blektorisë synon rritjen e prodhimeve blegtorale nëpërmjet shtimit te krerëve dhe strukturës së bagëtive me 25% në vitin 2010 dhe që mund të përballohen nga kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjerë, si dhe Pastrimi dhe përmirësimi racor me tendencë ruajtjen e llojit të vendit do të jetë subjekt i vazhdueshëm i kujdesit të specialistëve të fushës.

MASAT :

- Rritja e numrit të krerëve te gjedheve, te imtave dhe shpendeve
- rritja e kujdesit per kullotat natyrore
- shtimi i siperfaqes se tokes se mbjelle me faragjere
- Vaksinimi i përgjithshëm i kafshëve në të gjithë komunën.
- Ndërtimi i punës për pastrimin racor me tendencë që të ruajmë llojet e vendit.
- Inkurajimi nëpërmjet kreditimit të individeve të interesuar për ngitjen e një njësie për përpunimin e produkteve blektorale në fshatin Fushe Bulqize.
- Studim për rritjen e peshkut troftë dhe,
- shtimin e prodhimit të mjaltit duke nxitur aktivitetet ekzistuese

1.2. ZHVILLIMI I BUJQËSISË NATYRORE/BIOLOGJIKE

TENDENCA e rritjes së sipërfaqes së mbjellë me frutikulkturë dhe foragjere, klima e favorshme dhe përdorimi i sasive të vogla të pesticideve ka sjelle shtimin e produkteve biologjikisht të pastra.Kjo tendencë është kthyer në një objektiv të banorëve të komunës të cilët synojnë rritjen nga viti në vit të sipërfaqeve dhe rrënjëve me kulturat frutore duke shfrytëzuar kushtet e përshtatshme klimaterikotokësore dhe eksperiencën e gjatë të fermerëve në këtë sektor. Shtimi i prodhimit të frutikulturës është shoqëruar me ambicjen për të përmirësuar infrastrukturën e magazinimit dhe të konservimit të produkteve.

SYNIMI STRATEGJIK:

Rritja me 20% e prodhimit bio, me prodhime bujqesore brenda 2012 ne komunen Fushe-Bulqize.

MASAT:

- Shtimi i sipërfaqeve me pemët frutore nëpërmjet mbjelljeve të reja si mollë, kumbulla, qershi të llojeve të vendit.
- Studimi dhe organizimi i punës për sigurimin në vend të materialit mbjellës të pemtarisë dhe bimeve të arave me qëllim që prodhimet të jenë natyrale
- Mbeshtetje për fermerët me kredi për mekanizimin e punimeve në bujqësi në fshatrat Fushe Bulqize,Dushaj e Kocaj dhe Dragu.
- Sistemimi i tokës, mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe vaditëse në fushat e fshatit Fushe Bulqize.
- Krijimi i marrdhënieve të qëndrueshme nëpërmjet Administratës së Komunës me Drejtorinë e Bujqësisë.
- Bashkepunim me bizneset e tregetimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore për të siguruar shitjen dhe perpunimin e prodhimeve bujqesore.

1.3. NXITJA E BIZNESIT TË VOGËL & TË MESËM

TENDENCA:

Komuna do të mbështesë individët, subjektet vendase apo të huaja të cilat planifikojnë të ngrejnë biznese të përpunimit të produkteve blektorale dhe bujqësore, rrobaqepsi, të zhvillojnë industrinë e përpunimit të bimëve medicinale, aromatike, dhe atyre industriale duke përdorur si krahë pune burimet njerëzore në komunë, si dhe mbështetjen e ndonjë iniciativë që synon shfrytëzimin e ujrave sipërfaqësore të rrjedhshme të komunës për prodhimin e energjisë elektrike duke ngritur dy çentrale ne Fushe Bulqize.

SYNIMI STRATEGJIK:

Krijimi i kushteve te pershtatshme per bisnesin e vogel e te mesem qe kerkon te investoje ne FusheBulqize ne shfrytezimin e resurseve humane dhe natyrore te komunes brenda 20012 dhe qe do te rrisin te ardhurat dhe numrin e te punesuarve ne komune.

MASAT:

- Studimi i tregut dhe inkurajimi i investitorëve privat për hapjen e një reparti për ***prodhimet artizanale*** të qëndisjes dhe rrobaqepsie në Fushe Bulqize (Për një përdorim më të mirë të burimeve njerëzore nëpërmjet kontraktimit me subjektet private vendase dhe të huaja prodhues të konfeksioneve që operojnë ne treg, si dhe identifikimi i tregjeve përkatëse të prodhimeve artizanale.
- Mbështetja e bizneseve egzistuese të ***përpunimit të gurit dhe drurit*** duke ju krijuar kushte lehtësuese për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre. 2008
- Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për zhvillimin e biznesit për grumbullimin, manipulimin dhe tregëtimin e ***bimeve medicinale, aromatike*** dhe industriale si çaji i malit, dëllinja, tërfili, serbela, luleshtogu, qershia te egra etj, me të cilat natyra e komunës tonë është e pasur.
- Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për shfrytezimin e ujrave sipërfaqsore të rrjedhëshme të komunës për ***prodhimin e energjisë elektrike*** duke ngritur dy centrale

PROJEKTET PER ZHVILLIMIN EKONOMIK NE FUSHE BULQIZE

- **Kanal Vadites ne fshatin Lepurake – Dushaj**
- **Kanal vadites Fushe-Bulqize – Dinemarini – Care**
- **Rregullimi i vijes se Gjurit, Shabane – Dile marini**
- **Rregulimi i vijes vaditese Kocej prej 3.6 km**
- **Sigurimi i vadijes te lagja Tezall**
- **Sigurimi i mbeshtetjes se fermereve me fidane rrushi, kumbulle, qershie dhe molle.**
- **1 qender sherbimi dhe furnizimi bujqesore**
- **Plan zhvillimi per Turizmin**
- **Pregaditja si vend turistik tek Segment i Pishave**
- **Nxitja e ndertimit te hidrocentralit te perroi i Palgjait.**
- **Nxitja e ndertimit te hidrocentralit te perroi i thate**
- **Nxitja e ndertimit te hidrocentralit te perroi i Dushaj**
- **Organizimi i Festes se Fushe-Bulqizes ne Maj, qe promovon vlerat folklorike dhe zakonere te zones.**

2. INFASTRUKTURA

Fusha Prioritare: Infrastruktura/ Shërbimet Publike

TENDENCAT:

Përmirësimi i Infrastrukturës dhe bashkë me shërbimet publike janë realizuar kryesisht në drejtim të zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, shtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujit të pijshëm dhe kanalizimit të ujrave të zeza, të cilat sigurojnë edhe shërbimet publike bazë me ndikim të madh në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqënies. Është përmirësuar gjithashtu rrjeti i kanalizimeve për uitje nëpërmjet rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve vaditëse dhe atyre kulluese ekzistuese. Me fokus mbrojtjen e mjedisit i është kushtuar rëndësi e veçantë mbrojtjes së pyjeve si dhe mbrojtjes së tokës nga erozioni. Në të njejten kohe eshte pergatitur nje plan rregullues per komunen i cili ka orjentuar zhvillimin e infrastrukturës dhe lehtesuar rishikimin në kohë të Planit Lokal Të Zhvillimit. Prioritet i është dhënë dhe përmirësimit të shërbimeve të tjera publike siç janë telekomunikacioni, shërbimi i pastrimit, forcimi i sinjalit televiziv etj .

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor.
- Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujrave të zeza.
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit ujitës dhe kullues.
- Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike, si posta, telefonia, dhe sinjali TV.
- Mbrojtja e mjedisit.
- Hartimi i planit rregullues

2.1 PERMIRESIMI DHE MIREMBAJTJA E RRJETIT RRUGOR

SYNIMI STRATEGJIK:

Permiresimi i rrjetit rrugor te komunes ne masen 90% brenda vitit 2012'

MASAT:

- hartim projektesh teknike cilesore dhe brenda standartave bashkohore
- asfaltimi i rrugeve kryesore te komunes
- mirembatja e te gjitheve rrugeve te komunes
- bashkepunim i mire me ministrite e linjes dhe me donatoret.

2.2. PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TE PIJSHEM DHE KANALIZIMET E UJRAVE TË ZEZA

SYNIMI STRATEGJIK:

Brenda vitit 20012 banoret e Fushe – Bulqizes te kene uje te pijshem dhe KUZ ne shtepite e tyre.

MASAT:

- zgjerimi i rrjetetit te ujesjellesve
- rikonstruksion i rrjetit te ujesjellesve
- mirembatja e ujesjellesve dhe cezmave publike
- ngritja e KUZ ne cdo fshat

2.3. PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE TË TJERA PUBLIKE, SI POSTA, TELEFONIA, SINJALI TV.

SYNIMI STRATEGJIK:
Brenda vitit 2012 te sigurohen sherbimet baze me cilesi per te gjithe banoret e komunes.

MASAT:
- ofrim me cilesi i sherbimit postar per cdo banor te komunes
- sigurimi i sinjalit TV me kanalet publike shqiptare
- ofrimi i sinalit te telefonise fikse dhe cilesi me sinjalin e celulareve
- nxitja e hapjes se sherbimeve riparuese elektronike ne komune

2.4. MBROJTJA E MJEDISIT

SYNIMI STRATEGJIK:
Krijimi i nje mjedisi te qendrueshem per te gjithe territorin e komunes se Fushe-Bulqizes, dhe shfrytezimi per eko-Turizem.

MASAT:
- shtimi i masave per mbrotjen e pyjeve dhe kullotave nga prerjet e paligjshme dhe zjarret
- shtimi i investimeve per mbrotjen e pjeseve te demtuara dhe te rezikuara nga erozioni.
- mbrotja e faunes nga gjuetia e paligjshme dhe zhdukja
- marrja e masave per pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve per te gjithe territorin e komunes.
- promovimi i vlerave turistike te mjedisit.

PROJEKTET E PERMIRESIMIT TE INFASTRUKTURES

- **asfaltimi i rruges Fushe –Bulqoze – Kryqezimi i 3 fshatrave.**
- **asfaltim i rruges Qender komune – Kocaj**
- **asfaltimi i rruges Sulzenele – Grop**
- **asfaltimi i rruges Dilemarini – Koderdane**
- **mirembatja e 28.6 km rruge ne komune**
- **ndertimi i ujesjellesit ne Koder dani**
- **ndertim ujesjellesi ne Allias**
- **ndertimi i ujesjellesit te Koculit**
- **ndertimi i kanaleve te ujerave te zeza ne Fushe – Bulqize**
- **menaxhimi i mbetjeve**
- **ndertimi i nje pike grumbullimi per mbeturinat**
- **Hartimi i projekteve teknike me standarte profesionale**
- **Pyllezimi dhe mbrotja e shtratit te perenjeve**
- **Pyllezime te reja dhe kujdes per pyjet komunale**

3. ZHVILLIMI SOCIAL

- **permiresimi dhe forcimi i sherbimit arsimor ne komune**
- **permiresimi dhe rritja e cilesise ne sherbimin shendetesor**
- **promovimi i vlerave kulturore dhe tradicionale te treves**

3.1. PERMIRESIMI DHE FORCIMI I SHERBIMIT ARSIMOR NE KOMUNE

SYNIMI STRATEGJIK:
Rritja e cilesise se sherbimit arsimor per komunitetin e Fushe-Bulqizes.

MASAT:

- rritja e invetimeve per objektet arsimore, godina, mjete, laboratore, terrene sportive etj
- krijimi i kushteve te mira per trasportin e nxenesve dhe mesuesve
- bashkepunim i mire me drejtorine Arsimore per zbatimin sa me te mira te politikave arsimore ne komune si metodologjine, gjuhen e huaj, teknologjine kompjuterike e tj
- kualifikimi i mesuesve dhe edukatoreve per te qene sa me profesional
- nxitja e komunikimit me komunitetin per te kontribuar ne rritjen e cilesise se shkollimit,

PROJEKTET:

- **Shtese kati ne shkollen 9-vjecare "Asllan Keta"**
- **Rikonstruksioni i shkolles fillore ne Fushe-Bulqize.**
- **Rregullimi i catise se shkolles ne Kocaj.**
- **Rregullimi i bibliotekes**
- **Krijimi i terreneve sportive**
- **pajisja me mjete mesimore dhe kompjutera e shkollave.**
- **Kurse gjuhe te huaj dhe kompjuteri**

3.2. PERMIRESIMI DHE RRITJA E CILESISE NE SHERBIMIN SHENDETESOR

SYNIMI STRATEGJIK:

Rritja e cilesise dhe kujdesit se sherbimit shendetesor per te gjiha grup moshat dhe banoret e komunes Fushe Bulqize.

MASAT:

- rritja e investimeve per godinat dhe infastrukturen shendetesore ne komune
- ofrimi i sherbimit shendetesor me cilesi dhe ne kohe per cdo fshat te komunes
- Permiresimi I kujdesit ndaj nenes dhe femijve
- Ngritja e konsultoreve ne ato fshatra qe mungojne
- Bashkepunim i mire me drejtuesit e shendetit publik ne komune dhe ne rajon.
- Kualifiki i i stafit te mesem dhe atij te larte profesional

PROJEKTET:

- **Mirembatja e qendrave shendetesore**
- **Pajisja e qendrave shendetesore me materialet e nevojshme**
- **Trajnimi i stafit profesional nga Kryqi i Kuq dhe programet e tjera shendetesore**

3.3. PROMOVIMI I VLERAVE KULTURORE, FETARE DHE TRADICIONALE TE TREVES

SYNIMI STRATEGJIK:

Krijimi i kushteve dhe aktiviteteve qe promovojne vlerat historike, kulturore, folkloristike dhe tradicionale te treves dhe tradites se zones.

MASAT:

- Permiresimi i jetes kulturore dhe artistike te banoreve te komunes
- Ruajtja dhe promovimi i vlerave kulturore dhe fetare
- Shtimi i masave dhe vemendjes per kulturen
- Organizimi i evenimeneteve folklorike dhe kulturor

PROJEKTET:

- **Ndertimi i nje muzeu etnografik**
- **Ngritja e ansamblit folflorik te zones**
- **Pesemarja ne e ansamblit ne evenimentet e rendesishme si Oda-Dibrane etj**
- **Promovimi dhe kujdesi per 22 kultet fetare te tarikatit Bektashi**
- **Organizimi i festes folklorike dhe popullore me 6 – maj (Dita e Shengjergjit)**
- **Promovim figurash te shquara te krahines, sportiste, artiste, mesues, stuiues, etj.**

4. QEVERISJA E MIRE LOKALE

TENDENCA:

Qeverisja e mirë në komunën Fushe Bulqize është bërë promotore e zhvillimit ekonomik dhe social. Strukturat vendim-marrëse dhe ekzekutive të komunës janë të hapura për një vendim-marrje me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit. Zbatimi i vendimeve është mbështetur në parimin e decentralizmit dhe përcaktimit rigoroz të përgjegjësive. Banorët e komunës gjejnë informacionin e nevojshëm, ndërsa iniciativat për biznes janë mbeshtetur dhe lehtësuar nga administrata dhe vendim-marrësit. Mbledhjet e hapura të këshillit, anketimet, publikimi i informacionit janë bërë mjete komunikimi gjerësisht të përdorshme ndërmjet komunës dhe banorëve të saj. Personeli administrativ është i qëndrueshëm dhe me kapacitete në rritje në përgjigje të dinamikes së zhvillmit dhe të nevojave të komunitetit.

SYNIMI STRATEGJIK:

Sigurimi i nje qeverisje te mire, demokratike, trasparente dhe ofrimi i sherbimeve me cilesi dhe ne kohe per komunitetin e komunes se Fushe – Bulqizes.

MASAT:

- Përmirësimi i kapaciteteve profesionale, administrative dhe vendimarrese per stafin dhe këshilltarët e komunes.
- Rritja e trasparences se qeverisjes vendore
- Rritja e bashkepunimit dhe pjesemarrjes se komunitetit ne proceset vendimarese dhe politik berese.
- Permiresimi i komunikimit mes administrades, keshillit dhe keshillave te fshatrave
- Krijimi i ambjenteve te pershtatshme per funksionim te mire te punes ne zyrat e komunes
- Rritje e bashkepunimit me komunat fqinje, keshillin e qarkut, drejtorite rajonale dhe ministrite, ne komunikim, pjesemarrje, structure dhe angazhim ne zbatim projektesh, ne ceshtje ligjore dhe menaxheriale si dhe ne diskutim apo hartim politikash.

PROJEKTET:

- **pregaditja e nje manuali personeli me procedurat, kodin e etikes dhe pershkrimin e detyrave dhe mardhenieve mes vetit dhe te treteve per komunene Fushe – Bulqize**
- **rregullore e brendeshme administrdes se komunes**
- **marrja pjese ne trajnimet e Njesise trajnuese dhe ne trajnimet e tjera qe organizohen per administraden publike dhe te zgjedhurit lokale**
- **rregullimi i zyrave dhe pajisja e tyre me kompjutera dhe pajisjet e tjera te nevojshme per pune**
- **mbledhje periodike te hapura me komunitetin**
- **tavolina te rumbullakta me keshillin e komunes dhe keshilat e fshatrave**
- **raporte me cilesi**
- **ngritja e nje kendi informativ**
- **hapja e nje wepage per komunen**

LISTA E PRIORITETEVE TE KOMUNES FUSHE-BULQIZE

- Rregulimi i vjes vaditese Kocej prej 3.6 km
- Kanal vadites Fushe-Bulqize - Dinemarini - Care
- Sigurimi i vadijes te lagja Tezall
- Nxitja e ndertimit te hidrocentraleve te vegjel te perroi i Palgjait.
- Nxitja e ndertimit te hidrocentraleve te vegjel te perroi i thate
- Nxitja e ndertimit te hidrocentraleve te vegjel te perroi i Dushaj
- asfaltim i rruges Qender komune - Kocaj
- mirembatja e 28.6 km rruge ne komune
- ndertim ujesjellesi ne Allias
- Kanal Vadites ne fshatin Lepurake - Dushaj
- promovimi dh kujdesi per 22 kultet fetare te tarikatit Bektashi
- Rregullimi i vijes se Gjurit, Shabane - Dile marini
- Sigurimi i mbeshtetjes se fermereve me fidane rrushi, kumbulle, qershie dhe molle.
- 1 qender sherbimi dhe furnizimi bujqesore
- Plan zhvillimi per Turizmin
- Pregaditja si vend turistik tek Segment ii Pishave
- Organizimi i Festes se Fushe-Bulqizes ne Maj, qe promovon vlerat folklorike dhe zakonere te zones.
- asfaltimi i rruges Fushe -Bulqoze - Kryqezimi i 3 fshatrave.
- asfaltimi i rruges Sulzenele - Grop
- asfaltimi i rruges Dilemarini - Koderdane
- ndertimi i ujesjellesit ne Koder dani
- ndertimi i ujesjellesit te Koculit
- ndertimi i kanaleve te ujerave te zeza ne Fushe - Bulqize
- menaxhimi i mbetjeve
- ndertimi i nje pike grumbullimi per mbeturinat
- Hartimi i projekteve teknike me standarte profesionale,
- shtese kati ne shkollen 9-vjecare "Asllan Keta"
- rikonstruksioni i shkolles fillore ne Fushe-Bulqize.
- rregullimi i catise se shkolles ne Kocaj.
- rregullimi i bibliotekes
- krijimi i terrneve sportive
- pajisja me mjete mesimore dhe kompjutera e shkollave.
- ndertimi i nje muzeu etnografik
- ngritja e ansamblit folflorik te zones
- mirembatja e qendrave shendetesore
- pajisja e qendrave shendetesore me materialet e nevojshme
- krijimi kushteve te mira per pune per administraden e komunes.
- bashkepunim me keshillin e komunes dhe keshillat e fshatrave
- motivimi i stafit dhe ngritja e tyre profesionale
- komunikim i mire me qytetaret
- ngritja e webpage per komunen ne internet

REALIZUESHMËRIA

Ky plan është i realizueshëm, pasi mbështetet mbi objektiva reale dhe mbi gjendjen reale ekzistuese. Ai bazohet mbi opinionet e të gjithë aktorëve potenciale lokalë si dhe në modele të suksesshme të propozuar prej tyre. Gjithashtu, në konsideratë janë marrë dhe opinione të specialistëve, objektivat e Mjëvjeçarit dhe Strategjia Kombëtare e Zhvillimit.

Ky plan do të realizohet nga:

***Komuna Fushë-Bulqizë**, që është hartuese e politikave dhe programeve, nxitëse, mbështetëse dhe zbatuese e shumë projekteve dhe aktiviteteve të këtij plani.*

***Komuniteti,** që janë përfituesit, prodhuesit, investuesit kryesore të këtij plani. Ata janë konsumatorë, fermerë, investues dhe kredimarrës për shumë aktivitete.*

***Shoqatat**, të cilat do të ndihmojnë në menaxhimin efiçent të shumë burimeve dhe mundësive për secilën fushë përkatëse të ekzistencës së tyre, të ujit, pyjeve, vreshtarisë, pemëtarisë, rinisë, sportit, artit etj.*

***Institucionet rajonale**, të cilat do mbështetin, koordinojnë dhe harmonizojnë këto politika me ato rajonale dhe kombëtare.*

***Bashkëpunimi** me fermerët, komunitetin, institucionet shtetërore si dhe organizata donatore financiare do të jetë çelësi i suksesit të këtij plani.*

METODOLOGJIA:

Grupet e perfshira:

Këshilli i Komunës

Hartimi i këtij plani nuk do të ishte i mundur pa kontributin dhe dedikimin e Këshillit të Komunës dhe të anëtarëve të përmendur më poshtë: Edmond Visha (Kryetar), Gezim Sala (Zv/Kryetar), Avni Keta, Bajram Keta, Emurlla Basha, Latif Lukani, Agim Karaj, Besim Tuci, Selim Alliu,Sinan Alliu, Afrim Suroci, Petrit Cara dhe Medi Hasa.

Komuna Fushe Bulqize: Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (PZHL)

Kryetari, (i zgjedhur nga grupi i PZHL) – Isuf Curri , Kryetari i Komunës

Antarë të Këshillit të Komunës - Edmond Visha, Gezim Sala, Avni Keta, Emurlla Basha dhe Agim Karaj.

Personel nga administrata e komunës – Asllan Daxha; Hasan Llani; Medi Peti,Sheqere Visha.

- Banorë me profesione të ndryshme, nga zona të ndryshme të komunës – Hasan Lami, Besnik Shabani, Vjollca Gjimi, Lime Sejdi, Florina Terziu, Hasan Daxha, Agim Balla, Gani Keta.
- Përfaqesues nga fshatrat: Sadik Karaj; Mustafa Cara; Gani Curri; Muharrem Hani;

Grupi i Monitorim Vlerësim me Pjesëmarrje (MVP):

Kryetar – Shkelqim Canga

Staf i komunës – Shefqet Balla,Shkelqim Canga

Numri total i anëtarëve në grupin e MVP: 7 anëtarë

Te tjeret: Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u bë i mundur edhe nga bashkëpunimi i frytshëm **Keshillin e Qarkut Diber**, me strukturen e Njesise se trajnimit qe eshte pjese e programit me Ambasaden Hollandeze per "Forcimin e Qeverisjes vendore ne Diber".

Porcesi i hartimit te Planit Strategjik u lehtesua, u keshillua dhe u udhehoq nga specialistet e **Qendres per zhvillime rajonale dhe ekonomike ALPIN** qe nga fillimi deri ne fund. Ne te u perfshine Shkendie Kaba, Nafije Jella dhe Genti Vranici. Specialistet e ALPIN, me njohurite e dhena qartesuan procesin, ngriten grupet, u mblodhen te dhenat, u krijua profili, u punua me fushat prioritare, u percaktua vizioni dhe prioritetet, u diskutua dhe u mblodhen opinionet nga komuniteti dhe grupet e intersit dhe plani kaloi ne miratim ne Keshillin e komunes.